

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023 – 2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ

I. QËLLIMI PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me anë të këtij projektvendimi realizohet miratimi i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030, Planit të Veprimit për zbatimin e saj si dhe Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore. Programi i Qeverisë 2021 – 2025 e ka vënë fokusin tek punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Europian, si dhe kërkesave për integrimin europian të Shqipërisë në EU, që brenda vitit 2030 të kemi një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse që mbështetet tek:
“Punësim cilësor dhe aftësim gjatë të gjithë jetës për të gjithë”

Objektivi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030 dhe plani i saj i veprimit është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitese të punësimit në vend nëpërmjet zhvillimit të aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim dhe mundësimi i punësimit të denjë për gra dhe burra nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës.

Plani i veprimit ka në qendër të tij rritjen e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës nëpërmjet reduktimit të mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet, Rritjen e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune dhe funksionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë.

Në përputhje me vizionin qeverisë, kjo strategji i shikon formimin profesional dhe punësimin të lidhura me njëra tjetrën, duke synuar që shërbimet e arsimit dhe formimit profesional të jenë ngushtësisht të lidhura me ato të punësimit.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj, ka për qëllimin vazhdimin e reformave të fushës, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në tregun e punës gjatë 8 viteve të zbatimit të Strategjisë së mëparshme.

Kombet e Bashkuara #Envision2030 - Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)
Qëllimi 8: Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë.

Relacion shpjegues për projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të orientimeve të Programit të Qeverisë, Ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030. Kjo strategji vjen në vijim të Strategjise 2014 – 2022 duke rishikuar objektivat në bazë të zhvillimeve të fundit dhe pritshmërive deri në vitin 2030.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 është “Punësim cilësor dhe aftësim gjatë të gjithë jetës për të gjithë”. Strategjia mbështetet në Qëllimet e politikës si më poshtë:

Qëllimi i politikës 1: Zhvillimi i aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për më shumë punësim

Objektivi specifik/strategjik 1.1: Reduktimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet

Objektivi specifik/strategjik 1.2: Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune

Objektivi specifik/strategjik 1.3: Funkcionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë

Masat prioritare që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave specifike/strategjike janë:

1. Zhvillimi i ofertës së AFP-së më relavant, fleksibël, të qeverisur bazuar në evidencë dhe që garanton vijueshmëri

Informacioni i gjeneruar nga sistemi i inteligjencës së aftësive do të përdoret për përshtatjen dhe përditësimin e ofertës së AFP-së dhe zgjerimin e ofertës së AFP-së pas të mesme. Me qëllim rritjen e atraktivitetit dhe fleksibilitetit të sistemit të AFP-së për të rinjtë dhe të rriturit, si pjesë e ekosistemit të të nxëniet gjatë gjithë jetës, sistemi i AFP-së do të garantojë vijueshmëri në ofrimin e programeve të arsimit profesional të mesëm me kohë të pjesshme apo në forma hibride dhe ofrimin e programeve të AFP-së pas të mesme . Do të përfundojë riorganizimi i ofruesve të AFP-së sipas planit të optimizimit të rrjetit të ofruesve publikë dhe në përputhje me zhvillimin e ekosistemit, si dhe do të ndërmerren veprime për rritjen e autonomisë së ofruesve publikë të AFP-së.

2. Forcimi i mekanizmave të garantimit dhe zhvillimit të cilësisë në sistemin e AFP-së

Rritja e rëndësisë dhe atraktivitetit të AFP-së garantohen nëpërmjet zbatimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kornizës dhe mekanizmave të garantimit të cilësisë, duke përfshirë (i) zhvillimin e kualifikimeve profesionale bazuar në metodologji që mbështeten tek rezultatet e

Relacion shpjegues për projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030”.

aftësive të punonjësve duke bashkuar përpjekjet me kompanitë, siç parashikohet edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027.

5. Njohja e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal

Njohja e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal synon t'u japë vlerë njohurive, shprehive dhe kompetencave të individit, për të mundësuar punësim ose pjesëmarrje në procese të mëtejshme të nxëni. Bazuar në kornizën ligjore për arsimin dhe formimin profesional dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, institucionet do të ngrënë sistemin e njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal. Plotësimi i kuadrit ligjor do të kryhet paralelisht dhe do t'i shërbejë dizenjimit dhe zbatimit të të gjitha fazave të procesit të njohjes së të nxënit të mëparshëm: identifikimit, dokumentimit, vlerësimit dhe certifikimit të njohurive, shprehive dhe kompetencave (rezultateve të të nxënit). Njëkohësisht, do të mbështetet procesi i zbatimit nëpërmjet përcaktimit të modaliteteve të financimit, duke eksploruar alternativa për të nxitur ndërmarrjet private ose individët për të investuar, nëpërmjet alokimit të burimeve njerëzore të kërkuara, krijimit dhe ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve, si dhe mbështetjen e individëve që do të marrin pjesë.

6. Transformimi digjital i shërbimeve të punësimit dhe i sistemit të AFP-së

Kjo masë prioritare do të sigurojë që shërbimet digjitale për punësim dhe AFP janë të disponueshme dhe këto shërbime përdoren nga punëkërkuarit, punëdhënësit, nxënësit/kursantët e AFP-së dhe ofruesit e AFP-së. Për këtë, institucionet do të vijojnë përpjekjet për digjitalizimin e proceseve të brendshme, produkteve digjitale për klientët dhe ndërlidhjen e sistemeve, në linjë edhe me platformat Europiane, si EURES.

Institucionet do të investojnë në digjitalizimin e proceseve dhe shërbimeve të brendshme të punësimit dhe AFP-së si dhe në avancimin e sistemeve të informacionit, dhe do të sigurojnë ndërlidhjen me ofruesit e jashtëm të punësimit dhe AFP-së për të siguruar që inputet dhe shërbimet e tyre janë të integruara në sistem. Kjo do të kërkojë edhe automatizimin e proceseve të punës në ofruesit publik të shërbimeve të punësimit dhe AFP-së, si dhe proceseve të garantimit të cilësisë.

Institucionet do të investojnë në një gamë të gjerë të produkteve digjitale për punëdhënësin dhe punëkërkuarin, si: regjistrimi dhe shpallja e vendeve të lira të interesit për punë ose praktikë në punë, përputhjet automatike për punësim dhe praktikë profesionale, gjurmimi i punësueshmërisë për shërbime punësimi dhe formimi, orientimi në karrierë, zhvillimi i aftësive të buta duke përfshirë aftësitë themelore digjitale, të cilat mund të aksesohen edhe përmes celularit. Institucionet do të zhvillojnë profile digjitale për punëkërkuarin (CV digjitale), të cilat do të ndihmojnë në optimizimin e modelit të ofrimit të shërbimeve të punësimit.

Paralelisht, institucionet do të zhvillojnë dhe administrojnë platforma interaktive online të AFP-së dhe do të ofrojnë mbështetje të targetuar të ofruesve të AFP-së për të përmirësuar dhe përforcuar lëvrimin e ofertës së tyre arsimore apo trajnuese në mësimin e përzier, mësimin online, e-praktika. Keto produkte digjitale do të vlerësohen dhe do të zgjerohen gradualisht për përdorim nga të gjithë ofruesit deri në vitin 2030.

1. Shërbime dhe programe nxitëse të punësimit e aftësimit duke përdorur ekosistemin e tregut të punës

Kjo strategji synon të përmirësojë efektivitetin e modelit të shërbimeve të punësimit me tre nivele. Institucionet do të zhvillojnë modele dhe qasje të menaxhimit të specializuar të rasteve të nivelit të tretë dhe do të ofrojnë shërbime për punëkërkuuesit në partneritet me aktorët e tjerë të tregut të punës me mbështetjen e të cilëve do të trajtohen në mënyrë të specializuar pengesat në tregun e punës të këtyre punëkërkuësve. Partneriteti i institucioneve të punësimit me aktorët e tjerë të tregut të punës do të mundësojë aktivizimin e eksperiencave dhe kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm në nivel qendror dhe lokal si organizatat joqeveritare, ofruesit publikë dhe privatë të trajnimeve, ofruesit e shërbimeve mbështetëse, ofruesit e arsimit bazë dhe të mesëm profesional për të rritur, dhomat e tregtisë, industrisë dhe zejeve, organizatat e punëdhënësve, agjencitë private të punësimit, grupe të tjera formale dhe jo-formale.

Në bashkëpunim me ofrues publikë, jopublikë dhe privatë do të dizajnohen dhe zbatohen programe të nxitjes së punësimit dhe aftësimit për grupet e cenueshme, si të rinjtë (si pjesë e skemës së Garancisë Rinore), personat me aftësi të kufizuara (si pjesë e Fondit Social të Punësimit), përfituesit në moshë pune nga familjet e mbështetura me ndihmë ekonomike, punëkërkuuesit afatgjatë, pakicat etnike, ata me arsim e kualifikim të ulët (si pjesë e ndërmarrjeve sociale, programeve të punës në komunitet, aktivizimit në punët publike të financuara nga bashkitë etj.).

2. Tranzicion i mbështetur dhe gjithëpërfshirës nga shkolla në punë për të rinjtë (NEET) nëpërmjet zbatimit të skemës së Garancisë Rinore

Qeveria shqiptare dhe institucionet e lidhura me punësimin, arsimin dhe aftësimin do të garantojnë që çdo i ri nën moshën 29 vjeç (NEET) të ketë një ofertë të denjë punësimi, trajnimi apo arsimit, brenda një periudhe të arsyeshme kohore nga momenti i identifikimit, në linjë me rekomandimet e Komisionit Europian. Për këtë, në bashkëpunim me ministrinë e linjës është hartuar një Plan Zbatimi për Garancinë Rinore, i cili parashikon disa reforma të ndara në katër faza: hartëzimi, angazhimi, përgatitja dhe ofrimi.

Për fazën e hartëzimit do të zhvillohen programe dhe instrumente për të parandaluar rritjen e numrit të të rinjve NEET duke u bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i AFP-së, do të ngrihet një sistem monitorimi për braktisjen e hershme të shkollës dhe do të përforcohet shërbimi i këshillimit në karrierë brenda institucioneve arsimore.

Gjatë fazës së angazhimit, për të shpërndarë informacionin sa më afër vendndodhjes të të rinjve, në bashkëpunim me partnerë dhe grupe interesi do të ndërmerren fushata informuese të bazuara në komunitet dhe fushata duke përdorur metoda inovatore angazhimi në rrjete sociale.

Gjatë fazës së përgatitjes, do të zhvillohen instrumente të reja regjistrimi në portalin e AKPA-s, do të rriten kapacitetet e stafeve të zyrave të punës për t'u shërbyer punëkërkuësve të rinj, si dhe do të përdoren partneritetet e krijuara ndërmjet atyre që ofrojnë shërbime individuale

kapacitetesh për stafin. Në të njëjtën kohë, Fondi Social i Punësimit do të bëhet operacional duke vënë në funksion mekanizmin e mbledhjes së kontributeve nga punëdhënësit në bashkëpunim me agjentin e deleguar për mbledhjen e kontributit (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve).

Në bashkëpunim me partnerët dhe grupet e interesit do të dizajnohen programe të reja dhe të përshtatura që nxisin punësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara në vendin e punës; si dhe instrumente të reja për mbështetjen e sektorit privat dhe publik për të akomoduar personat me aftësi të kufizuara në vendin e punës duke përfshirë sigurimin pajisjeve dhe shërbimeve personale të vazhdueshme (përshtatje e arsyeshme); të financuara nga Fondi Social i Punësimit. Institucionet do të ndërmarrin fushata informuese dhe ndërgjegjësuese për punëdhënësit dhe sektorin privat me qëllim avancimin e kulturës gjithëpërfshirëse në vendet e punës dhe ato trajnuese ose arsimore.

4. Rritja e përfshirjes së grave në tregun e punës

Kjo masë prioritare do të synojë rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, me fokus të veçantë integrimin e grave joaktive, duke promovuar politika të aftësimin, punësimin fleksibël dhe vetëpunësimin me perspektivë gjinore si dhe duke ofruar asistencë të shënjestuar për aktivizimin e tyre.

Për këtë qëllim, do të ndërtohen mekanizma për identifikimin e nevojave dhe profileve të grave joaktive nëpërmjet administratorëve socialë në nivel vendor si dhe mekanizma për të ofruar mundësi aftësimi dhe punësimi në sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë edhe eksplorimin e ekonomisë së përkujdesjes.

Institucionet do të hartojnë dhe zbatojnë programe për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës rural dhe bujqësor duke ofruar informacion dhe mbështetje për të aksesuar dhe zbatuar fonde për zhvillim, si p.sh. fonde për zhvillimin rural, agroturizmin apo turizmin.

Institucionet do të mbështesin gratë joaktive me sipërmarrjen dhe ekonominë sociale, prodhimin e produkteve vendore apo ekonominë e gjelbër, aktivitetet e biznesit online, si dhe vlerësimin e mundësisë së stimujve fiskalë në këta sektorë.

5. Fuqizimi dhe përmirësimi i efikasitetit të inspektimit në punë në të gjithë territorin e vendit

Institucionet do të forcojnë edhe më tej rolin e tyre në zbatimin e legjislacionit të punës, garantimin e sigurisë në punë dhe përmirësimin e kushteve të shëndetit duke u fokusuar në përmirësimin e monitorimit dhe inspektimit në vendin e punës si dhe promovimin e kulturës parandaluese dhe mbështetëse.

Për të përmirësuar monitorimin dhe inspektimit në vendin e punës institucionet do të punojnë në modernizimin, fuqizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve inspektuese, koordinimin e aktivitetit të tyre me institucionet e tjera të lidhura me punën, përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës së inspektimit dhe digjitalizimit të saj, zgjerimit të fushës së veprimit dhe

masës është përcaktuar në planin e veprimit të Strategjisë i cili është paraqitur në Shtojcën 1. Ndërsa, nën aktivitetet e secilës ndërhyrje do të pasqyrohen në planin vjetor operativ të secilit institucionit përgjegjës për zbatimin e Strategjisë.

Ministria do të krijojë Grupin Koordinues për zbatimin e Strategjisë i cili do të drejtohet nga Zëvendësministri dhe përbëhet nga zyrtarë përgjegjës të njësive organizative të Ministrisë, si dhe institucioneve vartëse (AKPA, AKAFPK dhe ISHPSHSH) dhe institucioneve tjera përkatëse siç është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Detyrat dhe përgjegjësit e Grupit Koordinues janë:

- Shqyrtimi i progresit në zbatimin e Strategjisë në bazë të informatave të mbledhura;
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe udhëzimeve për njësitë organizative të Ministrisë, institucioneve vartëse dhe institucioneve tjera përkatëse në të gjitha aspektet që lidhen me zbatimin e Strategjisë;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave ose/dhe veprimeve plotësuese për të siguruar zbatimin e Strategjisë;
- Përgatja e raporteve periodike të progresit dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë si dhe paraqitja e raporteve të rregullta të progresit pranë Qeverisë së Shqipërisë;
- Organizimi i takimit me partnerë më të gjerë si dhe paraqitja e raporteve të rregullta të progresit;
- Organizimi i ushtrimit të vlerësimit të jashtëm dhe reflektimi i gjetjeve kryesore në përgatitjen e planit të veprimit, etj.

Strategjia do të jetë pjesë përberëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) sipas Urdhërit të Kryeministrit nr. 157, miratuar me datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit në lidhje me zbatimin e veprimeve dhe masave prioritare. Monitorimi gjurmon veprimet, ndërhyrjet, burimet financiare të alokuara dhe të shpenzuara në baza të rregullta dhe krahason ato me planin e veprimit për të vlerësuar se në çfarë mase po zbatohet Strategjia. Monitorimi i performancës nga ana tjetër, monitoron rezultatet e arritura në nivele të ndryshme: (i) masat prioritare, (ii) objektivat specifike dhe (iii) synimet afatgjata të cilat përcaktohen si qëllimet e politikës (siç është shkalla e punësimit) kundrejt caqeve të caktuara. Monitorimi do të bëhet në bazë të informacionit të mbledhur rregullisht përmes sistemit të monitorimit. Megjithatë, monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve brenda masave prioritare, si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të bëhet në bazë të planit vjetor të punës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë si dhe sipas planin e veprimit të Strategjisë. Nga ana tjetër, monitorimi i performancës ose monitorimi i rezultateve do të bëhet në bazë të kornizës së monitorimit dhe vlerësimit që është përgatitur për këtë qëllim (bashkëngjitur në Shtojcë 2) ku janë caktuar treguesit të performancës për

Relacion shpjegues për projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030”.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023 – 2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj, u hartuan nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhërin nr. 60, datë 18.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030”. Në hartimin e këtyre dokumenteve morën pjesë përfaqësues të MFE, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, ekspertë të projektit të UNDP “Aftësi për punësim”, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si dhe është konsultuar me grupin thematic të Grupit të manaxhimit të Politikave të Integruara (GMIP)

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Plani i Veprimit janë publikuar për konsultim public.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 – 2030 dhe Plani i veprimit është konsultuar me ekspertë të fushës dhe shoqërisë civile gjatë muajit Tetor – Nëntor 2022. Gjithashtu kjo draft Strategji, është konsultuar me donatorët dhe përfaqësues të institucioneve Shtetërore si dhe në mbledhjen e Grupit Thematic të Grupit të Manaxhimit të Politikave të Integruara, në 14-15 Nëntor 2022.

Projektvendimi, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Plani i Veprimit 2023-2030 dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrin e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord me miratimin e këtij projektakti nga Këshilli i Ministrave.

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur dakord me miratimin e këtij projektakti nga Këshilli i Ministrave.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shprehur parimisht dakord me projektaktin, duke sugjeruar:

Sugjerimi 1: Në përmbajtjen e Draft Strategjisë të përdoret gjuha e ndjeshme gjinore: burra/gra; të rinj/të reja; punëkërkues/punëkërkuese, etj.

Ky sugjerim është marrë pjesërisht në konsideratë, kudo ku ka qenë e mundur. Është shmangur përdorimi i emërtimeve të të dy gjinive, vetëm në rastin kur një gjë e tillë vështirëson leximin dhe kuptimin e tekstit.

shërbimeve të punësimit, në përputhje me nivelin e punësueshmërisë së çdo punëkërkuesi të regjistruar.

Sugjerimi 11

Në planin e veprimit të Strategjisë (shtojca 1 e dokumentit strategjik), nën objektivin specifik 2.1. “Ndërmjetësim më i mirë në tregun e punës” është parashikuar ndërhyrja një ndërhyrje e veçantë për ndërmjetësimin në tregun e punës së përfituesve të ndihmës ekonomike, nëpërmjet “forcimit të bashkëpunimit institucional me institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve mbështetëse sociale, shëndetësore dhe arsimore për grupet e cenueshme, përfshirë konsolidimin e praktikës tripalëshe për ndihmën ekonomike (SHSSH/AKPA/bashki)”. Mendojmë se ky sugjerim është i reflektuar.

Sugjerimi 12 Pasaporta e indikatorëve është pjesë e projektaktit, si shtojcë (shtojca 2) e dokumentit strategjik. Mendojmë se ky sugjerim është i reflektuar.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është shprehur parimisht dakord me projektaktin, duke sugjeruar:

Sugjerimi 1 është reflektuar.

Sugjerimi 2 është reflektuar.

Sugjerimi 3 është reflektuar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2023-2025, në programin buxhetor 10550 “Tregu i Punës” dhe programin buxhetor 09240 “Arsimi i mesëm profesional”.

PROPOZUESI
MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
DELINA IBRAHIMAJ

